



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 62

Datë: 27 shtator 2021: Ora 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1.Hyrje: z. Arianit Elshani, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 59 dhe 60/2021.

2.Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

3.Aktivitetet e ZRPPC-së:

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.

4.Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi për ridestitim të buxhetit për shujta gjatë zhvillimit të trajnimeve për trajnerët e terrenit për zgjedhjet lokale 2021;
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për buxhet shtesë për asgjësim të materialit sensitiv të procesit zgjedhor të 14 shkurtit 2021, dhe të kutive që kanë përfunduar të gjitha procedurat nga gjyqësori;
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për buxhet shtesë për furnizim me kamera të QNR-së;
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer dhe ridestitim të buxhetit për printimin e doracakëve të trajnimit.

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Formave Zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021,
- Shqyrtimi dhe miratimi i mënyrës së përzgjedhjes të Personelit Teknik të QV-ve dhe sigurimit të automjeteve transportuese për materialet zgjedhore për Qendra të Votimit dhe Vendvotime për zgjedhjet lokale 2021.

5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik.

6. Të ndryshme.

1.Hyrje: z. Arianit Elshani, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Arianit Elashni: Për shkak të mungesës në mbledhjes së sotshme të kryesuesit të KQZ-së jam i obliguar duke e respektuar rregulloren e KQZ-së të zëvendësojë për këtë mbledhje, konstatoje që dy anëtare mungojnë, kryesuesi dhe z. Ilir Gashi. Fillimisht, para së të fillojmë më mbledhjen besoj që sekretariati ka marr masa që të respektohet vendimi qeverise më

masat anti covid që secili anëtare prezent këtu duhet të ketë testin PRC apo certifikatën e vaksinimit dhe ju është lejuar qasja në hapësirat e KQZ-së. Në rregull atëherë fillojmë më mbar vajtën e mbledhjes.

Kemi para vetes këtë rend dite, ka ndonjë kush koment lidhur më rendin e ditës? Në çoftë se nuk ka kush është për miratimin e këtij rendit të ditës që kemi para vetes, në rregull. Konstatohet që miratohet rendi i ditës. Fillojmë më piken e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 59 dhe 60/2021. A ka ndonjë koment lidhur më procesverbale ? Po z. Kurteshi?

Sami Kurteshi: I kam lexuar të dy procesverbalet dhe janë disa pa saktësi të vogla që mëndeje e humbin kuptimin në çështjet kryq. Unë do të ja dërgoj atij vërejtjet, po janë thjeshte lëshime gjuhësore që e humbin kuptimin. Do të ja dërgoj procesmbajtësit, faleminderit...

Arianit Elshani: Faleminderit shumë. Atëherë, kush është për miratimin e këtyre dy procesverbaleve më rekomandimin që e dha z. Kurteshi, të për mësohen ato lëshime teknike. Në rregull konstatoje që miratohen procesverbalet, vazhdojmë më piken e radhës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtare të KQZ-së, dje keni pranuar raportin me shkrim nga sekretariati lidhur më aktivitetet që janë zhvilluar gjatë javës së kaluar në kuadër të përgatitjeve për procesin zgjedhore të zgjedhjeve lokale që do të mbahen më 17 tetor. Një nder aktivitetet kryesore ka qene edhe identifikimi edhe marrja në shfrytëzim i qendrese së votimit në afërsi të qendrës së votimit 19/12/E e cila është në sallën e sporteve 1 tetori dhe e cila aktualisht shërben si qendër e vaksinimit dhe imunizimit të popullatës pra e njëjta salle ka shërbyer edhe për aktivitetet tjera të komisionit komunal të zgjedhjeve si depo për pritjen e materialeve zgjedhore nga secila komune edhe po ashtu shpërndarjen para ditës së zgjedhjeve të gjitha materialeve zgjedhore, sekretariati ka identifikuar lokacionin më të afërt të kësaj qendrës së votimit dhe ka kërkuar më shkrime nga universiteti i Prishtinës që të mundësohet shfrytëzimi i objekteve universitare në të cilat do të transferohej qendra e votimit 19/12/E, e cila ka qene në sallën 1 tetori pra më date 21 shtatore UP ka kthyer përgjigje KQZ-vë më an të së cilës miratohet kërkesa e KQZ-së për shfrytëzimit të objektit të fakultetit të edukimit e cila do të shërbeje në vend të sallës 1 tetori pra do të jetë qendra 19/12/E salla 1 tetori tani do të transferohet adresa në

fakultetin e edukimit që gjendet prapa bibliotekës kombëtarë. Po ashtu edhe për nevojat e KKZ-së do të përdoret salla e sportit të fakultetit të edukimit fizik dhe sportit për nevojat e KKZ-së që, ka qene në sallën 1 tetori. Këto dy aktivitete, janë përkrahur nga UP dhe do të shërbejnë nevojat e KKZ-së dhe sekretariati do të informoje vazhdimisht të gjithë votuesit që kane votuar në sallën 1 tetori që tani kemi ndërrime dhe adresa është në fakultetin e edukimit.

Në kuadër të procesit të nominimit të këshillave vendvotimit sekretariati ka marr të gjitha nominimet nga subjektet politike në secilën komune dhe nga data 22 shtatore e me tutje ka pranuar listën finale nga të gjitha KKZ-të dhe është bere verifikimi i këtyre listave pra brenda afatit mirëpo si rrjedhoje e këtij verifikimi rezulton se kemi prape një numër të madh konsiderueshëm që edhe janë në mesin e anëtareve të Këshillave te vendvotimit të nominuar po ashtu edhe në lista të vëzhgueseve për subjektet politike, sekretariati ka kthyer prapa këto lista më qellim që të përcaktohen secili subjekt së ku do të jetë funksioni i këtyre stafi që do të nominohen apo do të emërohen nga KQZ-ë, pra të përcaktohen a dëshirojnë më punuar si këshilla të vendvotimit apo si vëzhgues në ditën e zgjedhjeve te gjitha ato verifikime janë bere janë dërguar në secilën komune dhe tash i presim edhe plotësim ndryshimet, pra nga data 30 shtator deri më 2 tetor është koha ku duhet patjetër të behet emërimi i anëtareve të këshillave të vendvotimit. Për ndryshe sa i përket fushatës zgjedhore për periudhën dhjete ditore që e kemi pra nga data 16 shtatore deri me 25 shtatore sipas raporteve të KKZ-së janë paraqitur 233 kërkesa për të mbajtur tubime politikë duke e respektuar rregulloren zgjedhore për tubime politike dhe vendimin e qeverise për masat mbrojtëse, deri më datën 25 shtatore katër tubime politike janë mbajtur sipas raportimeve që i kemi pa i përfillur rregullat zgjedhore dhe vendimin e qeverise për masat anti covid, ndërsa prej 233 kërkesave për tubime politike 33 prej tyre nuk janë mbajtur fare që i bien që janë anuluar nga subjektet politike.

Po ashtu, aktivitet më rendësi të veçanta që duhet te veçohen është edhe takimet e sigurisë që i ka KQZ-ë takime të rregullta, pra sekretariati më policinë e Kosovës, prokurime e shtetit, PZAP-it dhe institucione tjera nënshkruese të marrëveshjes, ky takime është mbajtur më datën 22 shtator 2021, dhe janë njoftuar lidhur më të gjitha aktivitetet që janë në vijim dhe pritet deri në ditën e zgjedhjeve. Ndërsa sipas raportit që e kemi këtu përpara një nder aktivitetet që ka filluar nga sekretariati është edhe trajnimi i trajnerëve të terrenit, pra ky aktivitet ka filluar nga data 24 deri 26 shtator dhe është përkrahur nga akademia Policore e Kosovës.

Pra, tha z. Ahmetaj, duke ja dhënë KQZ-së në shfrytëzim sallat e trajnimit dhe KQZ-ë ka realizuar pra ka zhvilluar trajnimin e trajnerëve nga të gjitha komunat ku trajnimi ka qene i obliguar për të gjithë trajnerët në mënyre qe ky trajnim pastaj të pasohet për të trajnuar këshillat e vendvotimit, pra janë trajnuar mbi procedurat e votimit dhe numërimit, procedurat e votimit të personave më nevoja të veçanta dhe pranim dorëzimit. Pra ajo çka është më rendësi të theksohet këtu është sepse sekretariati në mënyre të veçante ka theksuar të gjitha ndryshimet procedurale të cilat i ka miratuar KQZ-ë në mënyre që edhe trajnerët të jene të fokusuar po ashtu përveç procedurave të votimit edhe numërimit, po ashtu edhe të paketimit të jene të fokusuar edhe në ndryshimet proceduralë që kane të beje më paketimin e materialit zgjedhorë dhe më rrjedhën e materialeve sidomos tek procedimi i fletave llogaritëse të kandidatëve. Trajnimi është përmbyllur më datën 26 shtator dhe tani jemi në fazën kur behet edhe vlerësimi nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të procesit të trajnimit të trajnerëve. Pra në pika të shkurta këto janë aktivitetet e sekretariatit gjatë kësaj jave, nëse keni pyetje mund të ju përgjigjem. Faleminderit.

Florian Dushi: Faleminderit kryesues, për këtë së çfarë tha krye shefi kam dy çështje, e para nëse keni parapare ndonjë forme të veçante të informimit për ndryshimin e këtyre qendrave të votimit në Prishtine sepse është numër i madh i qytetareve të Prishtinës të cilët votojnë në 1 tetori, dhe prandaj një mungese informacioni do të na dërgonte në një pjesëmarrje më të ulte të votimit prandaj konsideroj që do të duhej më pasur ndoshta ju edhe e keni paraparë. Këtë, nuk po e paragjykoje. E dyta, nëse mund të na njoftoni zyrtarisht më që jemi dëshmitare të disa telasheve që kane ndodhur në komunat veriore të republikës së Kosovë dhe nëse ka ndonjë problem deri në këtë faze më funksionimin e trupave tone zgjedhor atje dhe nëse keni parapare si sekretariat eventualisht masa për ta ruajtur eventualisht një far forme organizmin dhe funksionalizimin e këtyre trupave zgjedhor deri në ditën e zgjedhjeve...

Arianit Elshani: Faleminderit shumë, a dëshiron dikush tjetër fjalën ?

Burim Ahemtaj Sekretariati ka parapa informim duke e shfrytëzuar të gjitha mekanizmat për informimin e të gjithë votuesve që numri i tyre është rreth 5 mije votues që votojnë në sallën 1 tetori, pra do të përdorim përmes mekanizmave të KQZ-së, në qofte nevoja edhe përmes rrjeteve sociale po pak a shumë do të fokusohemi në informimin e të gjithë

votueseve për ndërrimin e adresës së qendrës së votimit. Pra nuk behet fjale për ndërrim të qendrës së votimit por vetëm te adresës nga salla 1 tetori në fakultetin e edukimit. Pra do të i përdorim të gjithë mekanizmat për të i njoftuar të gjithë qytetaret që do të votojnë në atë qendër të votimit.

Ndërsa, sa i përket funksionalizimit të KKZ-vë neper komunat e veçanërisht në komunën e Zubin potkoit kemi informacione se aktualisht ajo komune nuk është funksionale dhe na duhet të i përdorim të gjitha mekanizmat në mënyre që të ruhet funksionaliteti i zyrës kemi raporte që kane ardhur sot së askush nuk është duke dal në pune si KKZ-ë në komunën e Zubin Potokut, në raportet tjera po sa ti kemi raportet gati do të ju njoftojmë në hollësi për situatën në komunat posaçërisht në komunën e Zubin Potokut. Do të përgatitem raport dhe do të ju njoftojmë më kohë...

Sami Kurteshi: Megjithatë, atë z. Kurtishi e kishte një rekomandim edhe një kërkesë udhëzim që, ka të bejë me fotografimin e fletëvotimit me telefona prandaj çka është ndërmarrë apo, çka do të ndërmerret që kjo dekori të minimizohet ose të mos lejohet të ndodh...?

Burim Ahmetaj: I kemi udhëzimet dhe rregullat në bazë të të cilave ne duhet të sillemi në vendvotim si dhe aktualisht, ne duhet me i respektuar ato të cilat i kemi në fuqi, kështu që udhëzimet janë shumë të qarta: nuk lejohet fotografimi dhe më tutje do të merren masa ndaj të gjithë atyre që nuk e respektojnë vendimin për mos fotografimin e votës...

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:

Yll Buleshkaj: Faleminderit, para jush e kemi paraqitur grupin e ri të radhës për akreditim të vëzhgueseve i cili si total është 4672 e duke ja shtuar edhe 6769 që janë akredituar më herët, do behën 11.441 vëzhgues deri më tani. Ajo që vlen të ceket së sot është afati i fundit apo data e fundit për aplikimit për akreditim të vëzhgueseve nga subjektet politike dhe nga OJQ –të vendore ndërsa OJQ-të ndërkombëtare dhe mediat afati i fundit është 2 tetori. Që do të

thotë 2 tetori do të i bijën dite vikendi jo e rregullt e punës por zyra po ashtu do të punoj ashtu siç është duke punuar edhe gjatë këtyre vikendeve. Materialet i keni para jush....

Rekomandimi i pare është që PDK-ë të i akreditoje edhe 73 vëzhgues shtese, të cilët i kane plotësuar të gjitha kriteret për tu akredituar.

Arianit Elshani: Në rregull, kush është për miratimin e këtij rekomandimi? A po dëshiron dikush fjalën fillimisht lidhur më aktivitetet në qofte së jo, kush është për miratimin e rekomandimit të akreditimit të 73 vëzhgueseve të PDK-së ?

Miratohen.

Yll Buleshkaj : Ashtu siç është praktika për subjektet që rekomandoje shumë vëzhgues nuk i kemi printuar emrat por kemi në email të gjithë emrat e vëzhgueseve të cilët akreditohet ndërsa së bashku më vendim do të bashkëngjitet lista që keni në imell.

Partia politike e certifikuar AKR akrediton edhe 25 vëzhgues shtesë afatshkurtër.

Arianti Elshani: Kush është për miratimin e 25 vëzhguesve të AKR-së ?

Miratohen.

Yll Buleshkaj: Iniciativa qytetare Sloboda Shterpce ka aplikuar për akreditimin e 18 vëzhgueseve afat gjate të tyre brenda afatit edhe rekomandojmë akreditimin e tyre.

Arianit Elshani: Kush është për akreditimin e vëzhgueseve ?

Faleminderit, miratohen...

Yll Buleshkaj: Partia politike e certifikuar LDK ka aplikuar për akreditimin 4154 vëzhgues të cilët i kane plotësuar të gjitha kushtet për tu akredituar, dhe rekomandojmë akreditim të tyre.

Arianti Elshani: Kush është për miratimin e këtij rekomandimi ? Miratohen...

Yll Buleshkaj: Partia politike e certifikuar NISMA ka paraqitur kërkesën për akreditime të 88 vëzhgueseve të cilët rekomandojmë për akreditime.

Arianti Elshani: Kush është për miratimin e këtij rekomandimi? Miratohen...

Yll Buleshkaj : OJQ-ë Demokracia për Zhvillime ka aplikuar për akreditime të 8 vëzhgueseve afat gjate të cilët rekomandojmë për tu u akredituar për shkake që kane plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme ligjore.

Arianit Elshani: Faleminderit. Miratohe...

Yll Buleshkaj : Po ashtu, media vendore Zëri ka aplikuar për akreditimin e 6 pjesëtarë të medias për zgjedhjet lokale dhe rekomandojmë aprovimin e kësaj kërkesë.

Arianit Elshani: Faleminderit...miratohet...

Yll Buleshkaj : Iniciativa qytetare “Unioni i Blakqorrëve” ka aplikuar për akreditimin e 16 vëzhgueseve dhe rekomandojmë që ata të aprovohen.

Arianit Elshani: Kush është për miratimin e këtij rekomandimi. Miratohet...

Yll Buleshkaj : Partia politike e certifikuar “Jedinstvena Goranska Partija” ka paraqitur kërkesën e akreditimit për 140 vëzhgueseve të tyre dhe rekomandojmë që ata të akreditohen.

Arianit Elshani: Faleminderit. Kush është për miratimin e këtij rekomandimi. Konstatoj që miratohet...

Yll Buleshkaj : Organizata ndërkombëtare Misioni Vëzhgues i Unionit Evropian në Kosovë, e ka sjellë listën me 3 vëzhgues të ri të tyre të cilët rekomandojmë për tu akredituar...

Arianit Elshani: Faleminderit, kush është për miratimin e këtij rekomandimi? Miratohet...

Yll Buleshkaj: Media vendore Kosova info ka aplikuar për miratimin e 2 vëzhgueseve të medias të cilët rekomandojmë për tu akredituar sipas kërkesës.

Arianit Elshani: Kush është për miratimit të këtij rekomandimi? Miratohet...

Yll Buleshkaj : OJQ-ë vendore Syri Vizione nga Peja ka aplikuar për akreditimin e 49 vëzhgueseve dhe rekomandojmë që kërkesa e tyre të aprovohet.

Arianit Elshani: Kush është për miratimin e këtij rekomandimi? Konstatoj që miratohet.

Yll Buleshkaj: OJQ tjetër vendore instituti demokratik Kosova, ka paraqitur kërkesën e akreditimit të 61 vëzhgueseve afat shkurtër, të njëjtit kane akredituar më herët disa vëzhgues

afat gjate pas plotësimit të dokumentacionit rekomandojmë që të akreditohen edhe këta 61 vëzhgues .

Arianit Elshani : Faleminderit kush është për miratimin e këtij rekomandimi? Konstatoje që miratohet.

Yll Buleshkaj : Dhe rekomandimi i fundit vjen për OJQ-në vendore Prijateljstvo bez granica e cila, ka aplikuar për akreditimin e 26 vëzhgueseve dhe të njëjtët rekomandohen për tu aprovuar.

Arianit Elshani: Faleminderit. Miratohet...

4.Raporti i Këshillave të KOZ-së:

1. Shqyrtimi dhe miratimi për ridestitim të buxhetit për shujta gjatë zhvillimit të trajnimeve për trenerët e terrenit për zgjedhjet lokale2021:

Gordana Llaban: Të nderuar, ne s'i këshill, kemi mbajtur dy takime. Në takimin e mbajtur më 22 shtator, kemi pasur tri pika të rendit të ditës, por më e rëndësishmja është pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi për ridestitim të buxhetit për shujta gjatë zhvillimit të trajnimeve për trajnerët e terrenit për zgjedhjet lokale2021. Trajnimi veç është mbajtur në Akademinë e Policisë në Vushtrri, dhe në këtë aspekt, është i nevojshëm aprovimi i shpenzimeve sepse, në kohën e planifikimit të buxhetit ky trajnim në nivelin e mbajtur nuk ka qenë i planifikuar. Në trajnim, kanë marrë pjesë rreth 300 trajner dhe se kostoja e këtij trajnimi, përfshinë edhe fjetjen dhe ushqimin e 120 trajnerëve në Vushtrri.

Shpenzimet që i përfshinë ky trajnim, janë në vlerë prej: 5 940 euro.

Rekomandojmë për aprovim.

Arianit Elshani: Në rregull, ka ndonjë koment lidhur më këtë rekomandim këshillit për buxhet dhe financa? Nëse jo, atëherë po e hodhi në votim.

Kush është për miratimin e këtij rekomandimit që të destinohet buxheti për shujta gjatë zhvillimit të trajnimit për trajnerët e terrenit për zgjedhjet lokale 2021.

Konstatohet miratimin.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për buxhet shtesë për asgjësim të materialit sensitiv të procesit zgjedhor të 14 shkurtit 2021, dhe të kutive që kanë përfunduar të gjitha procedurat nga gjyqësori;

Gordana Llaban: Në takimin e sotshëm, kemi pasur disa pika dhe ndër më të rëndësishmet, i shqyrtojmë këtu! Ndër të tjera, kërkesën për buxhet shtesë për asgjësim të materialit sensitiv të procesit zgjedhor të 14 shkurtit 2021, dhe të kutive që kanë përfunduar të gjitha procedurat nga gjyqësori. Ne kemi planifikuar buxhetin prej 1000 euro, megjithatë ky buxhet është i vogël, dhe janë të nevojshme 2000 euro.

Ne si këshill, rekomandojmë KQZ –në ta rrisë koston: nga 1000, në 2000 euro në mënyrë që ky material të shkatërrohet, dhe të lirohet hapësira.

Arianit Elshani: E do fjalën dikush?

Sami Kurteshi: Faleminderit kryesues, nëse e kam kuptuar drejt kjo ka të bëjë me shkatërrimin e materialit që sigurisht, i ka kaluar të gjitha instancat dhe është për tu shkatërruar, vetëm s'po e kuptoj ka qene e parapamë një buxhet një mijë euro ai s'po del duhet dy mijë euro. Një pyetje e kam kush i shkatërron këto materiale. Së për shkatërrim kaq shumë neve po na kushtojnë më i ble më i bo të reja po na kushtojnë shtrenjtë tash edhe më i shkatërruar a bon vetëm pak më na sqaruar çka është në pyetje?

Arianit Elshani : Dëshiron dikush tjetër fjalën? Para së të vazhdojmë, po krye shef vazhdoni ?

Burim Ahmetaj : Sekretariati ka shikuar të gjitha format së si mundet më i realizuar asgjësimin e materialit që na obligonë edhe ligji më i shkatërruar të gjitha fletëvotimet pas procesit zgjedhore d.m.th brenda 60 dite për asgjësimin apo shkatërrimin e materialit mirëpo edhe shkatërrimi në vetvete ka edhe kosto që është planifikuar një kosto prej një mijë euro që do të mund të mbulohen këto shpenzimet e asgjësimit sigurisht duke ju nënshtruar një tenderi të hapur. Në tender të hapur, kanë marr pjesë operatorë të ndryshëm mirëpo situata është tani në këto momente që ky aktivitet nuk mund të vlerësohet pas një vlerësimi nga njësia

kërkuese se patjetër duhet të rritet edhe planifikimi në këtë masën e kërkuar në mënyre që te realizohet asgjësimi i fletëvotimeve shkatërrimi i fletëvotimit dhe të lirohen kutit e votimit të cilat do të i përdorim për zgjedhjet lokale që do te mbahen më 17 tetor d.m.th edhe asgjësimi edhe shkatërrimi i materialeve e ka koston e vete mirëpo kjo ishte përtej planifikimeve dhe për këtë arsye kemi ardhur edhe më vesimin e njësisë kërkuese së na duhet patjetër më qellim që të realizohet ky aktivitet dhe të i përdorim kutit e votimit përsëri për këto zgjedhje.

Ibrahmi Selmanaj: Faleminderit kryesues, unë nuk po e shoh probleme ndemjen e mjeteve, mirëpo po më intereson a ka një afate të parapare të cilët do të jete dita e fundit ose afati i fundit në mënyre që ne jemi te gatshëm sepse zgjedhjet vetëm se janë afruar, d.m.th. parametrat e masës ose masës që ka ndër marr sekretariati do të kemi afatin e fundit kur ka më kane ekzekutimi i materialeve te cilat nuk na hynë në pune.

Arianit Elshani: Z. Kurteshi, pastaj krye shefi ?

Sami Kurteshi: Megjithatë pyetja ime ka të beje më çështje konkrete, a është fjala për shkatërrim të letrës, apo ka të bëjë edhe me shkatërrimin e ndonjë materiali tjetër të veçantë. E dyta, këto a nuk dërgohen ndonjë fabrike të letrës apo për riciklime apo duhet të shkatërrohen në një mënyre speciale unë mundem më marr me mend së ato komeditë se far materiale tani ju ka kaluar më afati po pak po me duket d.m.th riciklimi i letrës shkatërrimi i letrës realisht nuk do të duhej më kushtuar sepse, prodhuesit e letrës e marrin atë dhe e racionojnë e ripërpunojnë edhe ju hynë në pune në të vërtet është njëfarë pasurie e gatshme po tani sinqerisht jam konfuz në këtë drejtim.

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ka bërë një analizë dhe një vlerësim se si është mënyra më e mirë me i asgjësuar! Ne, e kemi shikuar edhe opsionet përmes djegës së fletëvotimeve mirëpo, gjithçka edhe djegia e tyre ka koston e vet sepse ne duhet më gjete lokacionin ku duhet të dërgohet duhet të transportohen më kamionë të gjithë ato materiale. Pastaj duhet më angazhuar edhe staf që e kryen krejt punën teknike kështu që kur të kthesh në anën tjetër kosto më e lehte për KQZ-ë është më i asgjësuar më i gri sikur praktika që ka qene më e hershme për më i gri letrën sesa më i dërguar neper furra për tu djegur d.m.th e kemi shikuar edhe këtë opsione mirëpo edhe ajo e bart koston e vete për angazhimin e resurseve qofte njerëzore edhe resurseve më pajisje më mjete të transportit.

Ndërsa, sa i përket realizimit të këtij aktivitetit duke e respektuar të gjitha procedurat e prokurimit do të ju dërgojmë ftese të gjithë operativë që kane marr pjese në tenderin e hapur, do të dërgohet ftese dhe do të shkojmë në procedura te përsheptuara në mënyre që të realizohet kjo edhe jemi shumë optimist se ne procedura të shkurtuara do realizohet brenda afatit dhe do të lirohen kutit para së të filloje distribuimi i kutive të votimit neper secilën komune. Kështu që më afat jemi akoma mirë në këtë aspakët mirëpo na duhet patjetër kërkesa që kemi adresuar në KQZ-ë në mënyre që të realizohet ky aktivitet për ndryshe nuk do mund te i kemi kutit e votimit nëse për shkak të situatës që jemi tani edhe tre jave ditë para ditës së zgjedhjeve.

Arianit Elshani: Faleminderit, unë e kam një pyetje qe lidhet më këtë kërkesë një sqarim qofte nga këshilli për buxhet qofte nga ju, lidhur më kërkesën për buxhet shtese, a jemi duke kontraktuar kompani për grirje të letrës apo jemi kontaktuar kompani operatori ekonomik i cili, e bënë pastaj edhe riciklimin e saj. Pra, në qofte se ajo e bene riciklimin e saj ajo kompani që kontraktohet nuk po mendoj që të alokojmë mjete ose të hapim procedura tenderuese. Pra kjo është pyetja që jemi konkret, kuptuam qe nuk asgjësohen nuk digjen ato ato fletëvotime, por copëzohen. Pra, në qofte se copëzohen, a përdoret nga ai operator për riciklime apo ndonjë kompani tjetër sepse do te duhet që ato letra ne momentin që përdoren për riciklime ne të mos alukojmë buxhet apo mjete për këtë detyre ?

Alim Rama: Vetëm së të plotësohem se pak a shumë temën e njëjte, çka ndodhe pastaj më ato letrat që shkatërrohen ato në QNR-ë a mbesin ato a i merr operatori që shkatërrohet më veti apo përsëri krijohet tenderi që të shiten ato?

Burim Ahmetaj: KQZ-ë obligohet më ligj që këto fletëvotime të asgjësohen të shkatërrohen mirëpo nuk e përcakton mënyrën se si duhet të shkatërrohen, thash edhe më herët kemi shikuar edhe opsionet tjera, kemi shikuar edhe përmes ankandit publik ku interesimi ka qene zero në këtë aspekt kemi shikuar edhe mundësin e djegies që kosto del po thuajse, ma e madhe sesa kjo kosto që mendojmë përmes grirjes dhe kjo është opsioni që për dekada të tere KQZ-ë e praktikon për më i shkatërruar fletëvotimet edhe gjitha materialet zgjedhore pas secilit proces zgjedhor dhe, me grirjen e këtyre materialeve sipas praktikave gjithçka obligohet operatori më pastruar edhe asgjë pastaj nuk mbetet në KQZ-ë d.m.th, lirohet KQZ-ë prej gjithë materialit zgjedhore; prej momentit të shkatërrimit së grirjes së tyre që praktikisht i bijën që

operatori i merr këto. Procedura ka qene e hapur kane ofertuar operator mirëpo të gjitha ofertat kane qene përmbi shumen e planifikuar.

Arianit Elashni: Kam një kërkesë këtu ndoshta këshilli për mardhanë më jashtë mundet të trajtoj këtë sa i përket edhe domateve që ne e kemi letrat të cilat na servojne gjate mbledhjeve të KQZ-së mirëpo edhe të këshillave dhe besoj që është e nevojshme që të kontaktohet mendoj ndonjë OJQ-ë për riciklimin e letrës dhe ndoshta të behet edhe një marrëveshje lidhur edhe më fletëvotimet te cilat e kalojnë pastaj at afatin e materialit sensitiv që quhet deri në ditën e mbajtës së zgjedhjeve pas përfundimit të gjitha atyre procedurave që i kemi në QNR-ë prandaj mendoj që këshilli për marrëdhënie me jashtë, mund të inicioje një kërkesë të tillë që të diskutoje lidhur më këtë çështje që të mos shpenzojmë kosto pastaj edhe më asgjësimin e këtyre materialeve mirëpo edhe më këto që kemi për çdo dite edhe që realisht hodhën në kontejnerë e pastaj ku e dimë a përdoren për riciklime apo jo.

Burim Ahmetaj : Këtë që po e thoni ju kryesues mund të realizojmë për zgjedhjet lokale që do të mbahen tani, do të kemi kohen e mjaftuar për të zhvilluar në kushte normale ndërsa sa i për këtë zgjedhjeve që janë duke u bere të gjitha përgatitjet për më u organizuar ne nuk kemi numër të mjaftuar të kutive të votimit nëse nuk lirohen këto materiale, pra nuk shkatërrohen dhe lirohen kutit që të njëjtat do të i përdorim në zgjedhjet lokale kështu që rrezikojmë shumë këtë aspekt.

Arianit Elshani: A ka dikush dëshiron fjalën ose ndonjë koment lidhur më këtë rekomandim të këshillit për buxhet dhe financa ? Nëse jo, po e hedhi në votim. Kush është për ?

Miratohet.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për buxhet shtesë për furnizim me kamera të QNR-së:

Gordana Llaban: Kemi shqyrtuar edhe kërkesën për buxhet shtesë për furnizim me kamera të QNR-së. Në buxhet janë planifikuar 2500 euro, megjithatë në teneder nuk ka pasur ofertat të zbatueshme, sepse duhen edhe 800 euro shtesë. Kjo i bie, 3300 euro.

Ne, rekomandojmë miratimin e kësaj shtese prej 800 euro.

Arianit Elshani : Faleminderit shumë, kam një pyetje, behet fjale për kamerat të cilat janë në hapësirat e QNR-së. Në rregull dëshiron dikush fjalën?

Sami Kurteshi : Unë i pash, i vëreja këto tejkalime këto kërkesa të reja për buxhet shtese tani kamerat i kemi marr ne, kamerat s'janë tonat. Zonja kolege, për mua është një çështje që duhet të sqaruar për çka është fjala konkretisht, për kamera ne kemi dëgjuar së janë marr nja 50 kamera, tani ka edhe kamera të tjera në QNR-ë. Përveç, atyre çka o në pyetje ?

Gordana Llaban: Po, ne i kemi marrë 50 kamera nga Shqipëria, por QNR nuk është krejt e mbuluar. Dhe, për të qenë e tëra e mbuluar, duhet marrë – blerë kamera shtesë. Dhe, në tender nuk ka pasur ofertë me këtë çmim, prandaj duhet shtesë

Florian Dushi: Faleminderit, tjera herë është mirë që Sekretariati kur propozon ridistnim për me pas mundësi që ne me e marr një vendim, vendimi duhet me i përmbajte të gjitha informacionet: është më rendësi të theksohet fakti nga cila linjë buxhetore i marrim ato 800 euro...?

Arianit Elshani : Faleminderit, sigurisht që sekretariati duhet të përfshije edhe në vendimet e tyre që jepen kryesuesit lidhur më bartjen e mjeteve nga cili kod buxhetor pra të specifikoni qarte së nga ku barten që pastaj të jemi në rregull edhe në raportin e auditorit mirëpo edhe të mos bëjmë ndonjë shkelje për shkaqe ndoshta teknike.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryesues, të gjitha kërkesat janë analizuar dhe pastaj janë dërguar ne departamentin për buxhet dhe financa dhe janë trajtuar si kërkesa më mundësin së mund të kemi buxhet shtese dhe nga cila linje buxhetore mundem të i marrim, përdere sa nuk e kemi të rregulluar këtë pjese nga kompetenca e krye shefit që mund të bej ridestime për disa operacione apo disa aktivitete që mund të zhvillohen kemi pa të udhës që këtë ta dërgojmë në KQZ-ë së ne fund të fundit KQZ-ë është ajo që e miraton buxhetin dhe duhet më ditë edhe KQZ-së se kah po i dërgojmë të gjitha parat, këto janë për qëllime të kryerjes së disa funksioneve apo operacioneve dhe më procedura jemi në rregull deri në këtë moment dhe rekomandojmë që të miratohet rekomandimi nga njësia kërkuese dhe duke pasur për baze edhe shqyrtimin apo aprovimin nga departamenti i financave dhe po ashtu i kemi edhe konsultimet më auditorin e brendshëm dhe në këtë aspekt konsiderojmë që jemi shumë në rregull dhe nuk kemi ndonjë shkelje procedurale.

Arianit Elshani: Po krye shef por ajo që kërkoje z. Dushi ne si anëtare ndoshta ju në këshillin për buxhet dhe financa, e dini se nga cili kod buxhetor alukohen ato rialukohen ato mjete në tjetrin kod buxhetor mirëpo është mirë që ato të jenë në këto rekomandime dhe në këto vendime të specifikohen qarte së nga ku merren dhe nga ku barten ato mjete më qene se siç e thate edhe ju buxheti aprovohet nga KQZ-ja dhe shqyrtohet po ashtu edhe nga këshilli për buxhet dhe në fund të vitit kur behet edhe raporti financiar i vitit ne të dimë sakte se nga ku janë bartur ku ato mjete të cilat janë të qytetareve.

Në rregull në qofte se nuk ka dikush ndonjë koment lidhur më ketë kërkesë për kamerat për buxhet shtese për furnizime më kamera të QNR-së të cilët do të vëzhgojnë punën e stafit në mënyre të përgjithshme pra jo specifike në secilën tavoline veç e veç dhe aktivitetet që zhvillohen në QNR-ë para procesit dhe pas procesit të zgjedhjeve pas ditës së zgjedhjeve, ka ndonjë kush koment ?

Sami Kurteshi: Po, unë përsëri po nguli këmbe nuk është çështja të shumë mjete pak mjete 800 euro, 1000 euro dhe sigurisht kjo nuk është çështja që duhet të diskutojmë kur i ndajmë nja 5, 6 milionë euro, për mua është çështja që këto unë si anëtar i KQZ-së nuk po e kuptoj mandej drejt sa kamera janë marr nga policia, publiku ka nevojë më e dit ketë sepse unë e di sepse unë e marr me mend, jo e marr po ketë po e shoh për çdo ditë mandej mendja del një lajme që policia i ka marr kamerat së çka? Edhe për klikime thotë policia e ka marr të gjitha kamerat e QNR-së edhe njerëzit klikojnë pastaj së nuk e dine çka ka ndodh prandaj unë jomë për ata për transparence të plote, mjetet janë kërkuar për kamera, kamerat janë të QNR-së, policia ka pas disa arsyeje më i marr disa kamera nga pjesët të ndryshme që ne nuk i dimë, ende nuk i ka liruar së janë duke u zhvilluar hetimet dhe kjo është ajo që unë po e kërkoje, nuk po e di sa kamera, nuk po e dije kur i ka marr policia çka ka bo, e para e dyta ketë unë po e ilustrujë më diçka tjetër edhe mendoj së këshilli për informime mund të nxirr ndonjë rekomandim në ketë drejtim.

Dje, del titulli në dy portale thotë kështu diçka nuk e di saktësisht nuk është edhe më rendësi KQZ-ja thotë apo s'di çka përsëri do të votojnë të vdekurit d.m.th një titull skandaloz pa e sqaruar mire që është i dëmshëm për publikun ende publiku në Kosovë mendon, përsëri po i mbushkan kutit kah 120% , 117% apo 130%, unë e di saktësisht që në ketë KQZ-ë kemi diskutuar disa here për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e këtyre KQZ-së më ARC-në për dorëzimin e listave të rifreskuara dy dite para zgjedhjeve më emrat e personave që heqin dore

nga shtetësia dhe më emrat e personave të vdekur dhe përsëri mandej del një titull që nuk e sqaron thelbin e çështjes po merret sigurisht më klikime edhe unë po them, kur e sheh në fund e lexon krijon përshtypjen sikur diçka është e qëllimshme po done një havori më u shkaktuar më fjale , ne kemi thane që dy ditë para zgjedhjeve do të dorëzohet kjo liste pastrimi i listave të votuesve nga personat e vdekur, pastrimi absolut është i pa mundur sepse edhe brenda dy ditëve kane më vdekur në Kosovë njerëz që nuk kane mu regjistruar kane më qene në lista që kane drejt vote mirëpo ajo nuk sqarohet mandej, mandej thotë vetëm personat e vdekur kane më votuar, kjo është vetëm si shembull dhe ndoshta ndërmerrni diçka këshilli për informim më sqaruar këtë çështje po kur ne bëhemi transparent deri në fund edhe ju shpjegojmë ato që i dimë edhe që i kemi faktet mandej mundësia e keqpërdorimit të informimit publike behet shumë më e vogël ka prej atyre që se kuptojnë ka prej atyre qe nuk rrinë deri në fund më dëgjuar për çfarë është fjala, ka prej atyre që si konsultojnë fare dokumentet por vetëm shënojnë por ne e kemi për obligime më sqaruar gjithçka deri në fund që qytetaret votuesit më pas të çartë çka është duke ngjare në lidhje më votuesit, në lidhje më kutit

Në lidhje më kamerat, në lidhje më këta ky është qëllimi im, a janë 800 euro apo a janë 1000 euro ajo nuk ka më luajtur rol sepse ne ndajmë shumë e më shumë mjete kjo për mu është më rendësi të mos bartet asnjë informate gabim jashtë KQZ-së lidhur më vendimet edhe më çështjet që ne i sqarojmë i diskutojmë dhe marrim vendime këtu, faleminderit.

Qemajl Kurtishi: Faleminderit. Unë e kuptoj brengën e Kurteshit, dhe ne duhet të kemi vëmendjen. Sekretariati, është nikoqir i mirë, dhe ne përsëri do të kemi raport se ku shkojnë paratë, si menaxhohen. Ne, kemi auditor të brendshëm, të jashtëm dhe unë jam që të informohemi në detaje, por janë edhe mediat, disa korrekte disa jo...

Ne, të punojmë korrekt, me përgjegjësi por e dimë që janë shumë procedura, dhe në fund ne, do të informohemi me siguri informacione të tjera, dhe çdo gjë që duhet kalon në përgjegjësi të ndara. Patjetër, ne duhet të punojmë mirë, por janë edhe organet e caktuara, procedurat...

Alim Rama: Ne në Këshill për Buxhet dhe Financa kemi marrë më shumë informata , e drejtë që edhe këtu në KQZ informatat bazike të epen kështu që kostoja pse nuk e ka përmbushë 2500 euro ka qenë arsyeja se disa pajisje janë marrë nga policia për shkak të hetimeve që kanë ndodhë në zgjedhjet e shkurtit dhe kjo informatë ndoshta kishte mjaftuar që na e kemi

edhe më të lehtë të vendosim po ashtu kisha kërkuar që në vendim të ceket nga ku merren paratë qysh e ka kërkuar z. Dushi para se me votua në d.m.th., para se me votu të dimë prej ku merren mjetet ,qysh destinohen edhe në anën tjetër të ceket arsyeja që janë disa pajisje shtesë nuk hyjmë në detaje cilat janë ato por janë pajisje shtesë edhe ato kanë të bëjnë për shkak të hetimeve që janë duke bërë policia nga procesi i shkurtit që kanë ndodhë në QNR.

Arianit Elshani : Na nevojiten sqarime se prej kujt merren , a i keni informatat apo vazhdojmë tutje ndërkohë është mirë.....këtë debat është dashtë më përfshi ju në Këshill për buxhet ju kush e kush jeni anëtarë nuk po e di

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it: Buxheti, është planifikuar për procesin për zgjedhjet lokale në buxhetin e zgjedhjeve , buxheti për të cilin diskutohet i takon kategorisë mallrave dhe shërbimeve përkatësisht pajisjeve të tjera nën 1000 euro , për zgjedhjet lokale që do të mbahen tash në vjeshtë janë të planifikuara në këtë kategori 7750 euro prej të cilave 2500 kanë qenë për kamera , 4000 për leximin e barkodeve , 3000 për një sëitch të portit të teknologjisë informative dhe 950 euro për sistem për menaxhimin e vijueshmërinë e stafit në QNR. Ne, e kemi vlerësuar se në mesin e këtij buxheti të planifikuar kemi buxhet të mjaftueshëm për shfrytëzimin e këtyre mjeteve për blerje të kamerave po pasi është kodi i njëjtë janë pajisje tjera të njëjta janë në kodin 13509 nuk e kemi thënë prej kodit 13509 deri në kodin 13509 por këtu merren nga ky buxhet për blerjen e këtyre pajisjeve...

Arianit Elshani: Faleminderit, kush është për ? Konstatoj që miratohet kërkesa për buxhet shtesë në këtë pikë.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer dhe ridestitim të buxhetit për printimin e doracakëve të trajnimit:

Gordana Llaban: Është shqyrtuar edhe kjo pikë: Kërkesa për transfer dhe ridestitim të buxhetit për printimin e Doracakëve të Trajnimit. Tenderi i shpallur, ka qenë në vlerë prej 16 250 euro. Tenderi është shpallur, mirëpo ka pasur ankesë nga një ofertues. Prandaj, meqë ne nuk kemi kohë deri sa të realizohet ankesa, Sekretariati ka marrë vendim që doracaku të përgatitet nga ne. Cmimi i përgatitjes, është sipas vlerësimeve rreth 12 990 euro.

Florian Dushi: Faleminderit, unë po ju njoftoj, po ngrisë këtë çështje se skam pas mundësi me marrë pjesë në Këshill të Buxhetit, prandaj edhe nëse diskutohen shtesë nuk ka ndonjë telashe sepse këtu është vendi ku diskutohet përfundimisht dhe vendoset përfundimisht... Çështjen tjetër, ne e biseduam në KOZ sepse kemi problemin tjetër të ngjashëm me problemin e doracakëve problemin me forma dhe, ne nuk mundemi me konsideru që një ankesë e një operatori pengon zhvillimin e procesit më tutje sepse në fund të fundit, teknikisht e pengon realisht por ankesat janë të ligjshme dhe parashihen; Edhe në planifikim duhet me i paraparë edhe ne në këto situata kur mund të paraqiten ankesa të tilla prandaj ideja ishte që të shohim mundësi tjera dhe Sekretariati të vijë me dy propozime se si do duhej me zgjidh edhe çështjen e doracakëve, dhe çështjen e formave që është po ashtu identike dhe krejt kjo për shkak se mungon bordi, më duket quhet bordi i Shqyrtimit të Prokurimit Publik; Do të thotë në mungesë të një organi i cili do duhej me i shqyrtuar këto ankesa dhe me vendosë ne duhet të gjejmë alternativa për me ba zgjidhje për shkak të datës së zgjedhjeve.

Prandaj, tha z. Dushi, nëse si Sekretariat merrni përsipër që këto me i bërë vetë është diqka tjetër por megjithatë si kemi me vendosë në rastin e formave, dhe unë besoj që nuk kemi me vendosë njejtë që prapë format zgjedhore me i printuar këtu brenda Sekretariatit. Për këtë arsye, unë po kërkoj që çështjet, problemet e ngjajshme të zgjidhen në mënyrë uniforme dhe ne, u morëm vesh në KOZ që të kemi një rekomandim nga Sekretariati praktikisht nga Departamenti i Prokurimit se si duhet të zgjedhjet por, ju nëse konsideroni që jemi vonë atëherë, unë kisha kërkuar sqarime kur po thoni "brenda", a nënkupton që Sekretariati ynë (i madh e i vogël) kanë me u angazhuar me printuar doracak apo, keni forma tjera me ke keni kontratë...?

Sami Kurteshi: Tash janë edhe tri javë! Ne, as nuk jemi herët as vonë, kemi pasur 4 muaj kohë për përgatitje. Nuk mund të konstatoj unë se cilat forma, cilët doracakë është dashtë pak më herët me u përgatitë, cilët pak më vonë, cilat janë ndryshimet që s'kanë lejuar që këto mos me u përgaditë më përpara...! Me të drejtë e ceku kolegu Dushi: Sekretariati, duhet me i marrë parasysh të gjitha procedurat, afatet ligjore ne e dimë s'i janë ato dhe si është gjendja e institucioneve tona. Mua, pak po më shqetëson kjo çështja këtu 500, këtu 1000, këtu duhet me u shtypë...Kërkesa e z. Dushi, ku do të shtypen a vërtetë do të shtypen këtu brenda me këto aparate që i kemi, a ka ndonjë formë tjetër meqenëse nuk po mundet përmes prokurimit të tenderëve...? Ne, krejt këto vonesa në hapa, tregon se ne e kemi një problem me këtë

çështjen e prokurimit të tenderëve; Nuk është diçka e re sepse, ata që planifikojnë drejtë megjithatë nuk iu dalin shumë gjëra...Nuk e di a janë këto arsye pse KQZ-ja është vonuar, a janë arsye pse janë vonuar aspekti teknik; Nuk i kam të qarta aspektet dhe sinqerisht unë pak po shqetësohem sepse, ende nuk e kam të qartë cila është arsyeja e këtyre vonesave...

Burim Ahmetaj: Të gjitha këto aktivitete kanë qenë publike me procedura të rregullta dhe procedurat e rregullta nuk janë si procedurat që i zhvillojmë për zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të thotë që duhet të paktën 45 ditë prej njoftimit publik për tenderë deri te faza e hapjes së ofertave dhe vlerësimit d.m.th. është një periudhë kohe e gjatë për njoftime publike këto janë të rregulluara me ligjin e prokurimit pastaj e kemi njësinë e prokurimit që e kemi vetëm një person që duhet me i përgatitë rreth 30 dosje të tenderëve dhe për secilën dosje që duhet me përgatitë i ka specifikat e veçanta kështuqë njësia e prokurimit apo zyra e prokurimit nuk mundet të njëjtën kohë me i përgatitë të gjitha pas kësaj e kemi edhe kohën kur është bërë rishqyrtimi i buxhetit edhe miratimi i tyre dhe si rrjedhojë tash kemi ardh tek faza finale kur është zgjedhë operatori dhe nuk ka mundur të zhvillohet më tutje për shkak të ankesave të operatorëve të cilët pretendojnë që kanë të drejtë sepse nuk është përzgjedh si operatori më i sukseshëm , këtë ankesë në rastin e printimit të doracakëve e ka drejtuar në organin shqyrtues të prokurimit i cili nuk është funksional. Sekretariati, e ka mendimin e ekspertit që i jep të drejtë KQZ-së se vlerësimin e ka bërë drejtë mirëpo përderisa nuk është funksional OSHP-ja edhe me vërtetu edhe vendimin e ekspertit ne praktikisht nuk mundemi me vazhdua me atë aktivitet të prokurimit, sipas vlerësimeve që i kemi pas kemi konsiderua që shumë lehtë , ma lehtë mundemi me zhvillu këtë aktivitet me resurset tona duke i printua ,kemi një kontratë me AQP-në sa i përket tonerve, furnizimit me letra dhe duhet patjetër me angazhua resurse njerëzore për printimin e tyre ,për shkak të urgjencës që na duhet kur të fillon trajnimi këshillave të vendvotimit që ti kemi në dispozicion doracakët kemi parë të udhës që sipas vlerësimit që të shkojmë në këtë formë për ti printuar doracakët mirëpo situata është ndryshe kur vjen puna te formularët zgjedhorë se Sekretariati nuk ka kapacitete as nuk ka kurrfarë mundësie me printua formularë zgjedhorë të cilët janë të specifikuar në secilin detaj sipas procedurave se si do procedohej me materialin ditën e zgjedhjeve , qysh e thanë edhe anëtarët e KQZ-së jemi ardh në një situatë ku edhe s'mundesh me ia ndalu ankesën askujt se ka të drejtë elementare ankesën mirëpo aktiviteti nuk mundet me u zhvillu në këtë formë sepse i kemi edhe tri javë ditë deri në ditën e zgjedhjeve por kjo është më shqetësuese sa i

përket formave zgjedhore ndërsa sa i përket printimit të doracakëve kemi konsideruar me planin b që ti printojmë vetë ,është i njëjti buxhet është dashur për tu anuluar aktiviteti i prokurimit dhe ato mjete ti përdorim për qëllime të printimit dhe furnizimit me letër në mënyrë që të realizohet kjo me resurset tona njerëzore

Arianit Elshani: Faleminderit për sqarimin, është çështje që e kemi diskutuar në Këshillin për Operacione Zgjedhore mirëpo edhe në Këshillin për Buxhet , në KOZ vendosëm që për shkak të rekomandimeve që na u dhanë edhe nga zyra e prokurimit vendosëm që të dy pikat edhe format zgjedhore edhe çështjen e doracakëve ta sjellin një rekomandim nëse në mbledhjen e KQZ-së pra një rekomandim të saktë se si mendoni të procedoni tutje , e di që e keni planifikuar këtë formë në Këshill për Buxhet mirëpo KOZ vendosi që ky aktivitet të pezullohet deri nesër dhe të diskutoni mes vete si Sekretariat me te gjitha departamentet dhe divizionet që i keni brenda në mënyrë që të kemi një rekomandim ku edhe ju pra respektoni ligjin por edhe ne nuk bëjmë ndonjë rekomandim i cili mund të jetë edhe joligjor prandaj shqyrtoni ,diskutoni pastaj nesër ne e vendosim e hedhim në votim këtu, nëse nuk kalon rekomandimi atëherë udhëzoheni që të shqyrtoni deri nesër këtë çështje

Florian Dushi: Dy çështje kryesues meqë e hapa këtë temë është me rëndësi të theksohet që nuk jemi vonu dhe nuk jemi vonë sikur të funksiononte OSHP-ja me shqyrtua dhe vendosë ankesën , ne me vazhduar tutje në cilindo rast ,fakti që janë zhvilluar procedurat mirë e thanë që në njëri rast eksperti i OSHP-së ka vlerësuar që Sekretariati ynë ka vepruar drejtë në kuptimin e ndjekjes dhe zhvillimit të procedurave pra ajo që unë dua ta potencoj është që pa fajin e KQZ-së ,pa fajin e Sekretariatit ne mund të vonohemi për shkak që nuk ekziston organi shqyrtues nuk ekziston në përbërjen e tij OSHP përndryshe jemi në rregull dhe çështja tjetër unë mendoj që ne mund ta aprovojmë këtë rekomandimin për transfer të mjeteve sa i përket kësaj për mos t'iu kthyer në ndërkohë edhe njëherë por megjithatë ne duhet ti presim këto dy alternativa që na sjellë sekretariati për me i vendosë në dy rastet dhe prapë po ju them shikojeni mundësinë sepse nuk konsideroj që mund të kryhen sa u tha në KOZ më duhet 16.000 doracakë me dikund 1 milion faqe, me u printu na zyrtarët e Sekretariatit tonë sepse ata megjithatë kanë edhe punë tjera

Arianit Elshani: Në rregull, atëherë po e hedh në votim ? Kush është për miratimin e këtij rekomandimi ?

Konstatohet se nuk kalon ky rekomandim dhe kjo kërkesë mbetet që të shqyrtohet brenda Sekretariatit deri nesër, dhe të kemi një rekomandim të saktë se si duhet të veprimet lidhur me këta doracakë.

Nuk miratohet ky rekomandim...

5.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Formave Zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021:

Alim Rama: Atëherë, Këshilli për Operacione Zgjedhore ka shqyrtuar rekomandimin për mënyrën e përzgjedhjes të personelit teknik të qendrave të votimit dhe sigurimit të automjeteve transportuese për materialet zgjedhore për qendrat e votimit dhe vendvotimit për zgjedhjet lokale 2021 , në faqen e dytë e keni në formë tabelare pra ndarjen e personelit në qendra të votimit duke përfshirë numrin e tavolinave që do të jenë për secilën qendër të votimit varësisht prej vendvotimeve që ka dhe numrin e personave të cilët janë në tavolina ndihmëse. Duke e parë që është më mirë për tu organizuar një qendër e votimit, KQZ e ka zvogëluar numrin e personave në tavolina ndihmëse në qendra të votimit ku ka më pak se dy vendvotime duke ulur këtë vetëm në një person dhe janë të rregulluara edhe afatet kohore se deri kur duhet të bëhet përzgjedhja e personelit dhe e kombibusëve që do të jenë në funksion të këshillave pra Komisionit Komunal të Zgjedhjeve.

Njëherit, tha z. Rama, edhe një rekomandim shtesë në këtë propozim i cili ka ardhur nga zyra e terrenit ka qenë që personeli i tavolinave ndihmëse të jetë në 50% së paku njëri nga dy antarët që do të jetë në tavolinën ndihmëse për listën votuese që të ju tregojë ,ti udhëzojë ata se ku votojnë pra të jetë njohës i teknologjisë informative pra që të dijë të përdorë programet ,aplikacionet të cilat do ti shërbejnë për të gjetur votuesin dhe për ta udhëzuar atë drejtë pra ky është rekomandimi...

Burim Ahmetaj: Numri i kombibusëve, varet prej numrit të vendvotimeve që ka ajo komunë dhe në bazë të kësaj përcaktohet se sa do të jetë numri i kombibusave për secilën komunë dhe në këtë numër të kombibusëve për secilën komunë do të jetë rezervë deri në 10 % në rast se kemi prishje, defekte dhe nuk mundet me shkuar një kombibus në një hapësirë gjeografike shumë të lartë ose probleme tjera teknike dmth ky është qëllimi për ti pasur në rezervë kombibusat

Arianit Elshani: Faleminderit për sqarimet. A ka dikush ndonjë koment ? Nëse jo, atëherë kush është për miratimin e këtij rekomandimi ?

Miratohet.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i mënyrës së përzgjedhjes të Personelit Teknik të QV-ve dhe sigurimit të automjeteve transportuese për materialet zgjedhore për Qendra të Votimit dhe Vendvotime për zgjedhjet lokale 2021:

Alim Rama: KOZ ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe rekomandim të Sekretariatit lidhur me format zgjedhore pra forma të rezultateve të kandidatëve për këshilltar komunal dhe formën zgjedhore për rezultatet e kandidatëve për kryetar të komunës dhe diskutuam edhe më parë në kuadër të Këshillit për Buxhet dhe financa që kjo çështje lidhur me shtypjen e formave zgjedhore është çështje që do të rekomandohet nesër mirëpo ne sot do të miratojmë parimisht këto forma zgjedhore se si janë përmbajtësisht. Pra, është një ndryshim - dallim në raport me zgjedhjet e 14 shkurtit që ka ardhur si rezultat i vendimit të KQZ-së që personat të cilët nuk janë certifikuar si kandidat nga KQZ për shkak të mos plotësimit të kritereve juridike në broshurat që ne i kemi miratuar si KQZ është marrë vendim që numrat e tyre të cilët kanë aplikuar për të qenë në listë të jenë pa emër e mbiemër të tyre në broshura dhe kjo ka refkletuar në flikën domosdoshmërisht dhe, tash edhe në formularët zgjedhorë pra do të jetë një hapësirë në formularët zgjedhorë që mos të ketë bartje të votës të njërit kandidat tek dikush tjetër. Mirëpo, do të jetë një hapësirë do të jetë nr. 4 dhe varësisht prej kandidatit nr,te kandidatit do të jetë një vijë e cila nuk do të lejohet të mbushet numri aty po që do tua lehtësoj punën komisionerve edhe kryesuesve poashtu edhe në QNR gjithë atyre që do të jenë të angazhuar në proces të rinumërimit që të mos bëjnë bartjen e votave të njërit kandidat te tjetri pra të jetë saktë të dinë kujt me ia vendosë votat ,ky është dallimi i këtyre formave

zgjedhore në raport me zgjedhjet e 14 shkurtit ajo që kemi kërkuar edhe si KQZ. Ne, e kemi marrë si këshill që e kemi shqyrtuar në operacione zgjedhore që kemi kërkuar nga Sekretariati i cili veç e ka formuar një komision prej 7 personash në përbërje që ka shqyrtuar secilin komunë vec e vec secilin subjekt, duke e krahasuar broshurën, duke e krahasuar listën e certifikuar me formularët e rezultateve në mënyrë që të mos bëhet asnjë lëshim siç ka ndodhur në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 ku subjektit politik, në këtë rast PDK-së është harruar që të shkruhet në formular të rezultateve dhe votat e tyre janë bartur te një subjekt tjetër. Pra, nuk kanë qenë mirë të renditura ato formularë të rezultateve prandaj, ne si KQZ pas konfirmimit nga ky komision i përberë prej 7 personash, do ta kemi të bashkangjitur atë konfirmim dhe do të fillojnë me shtypjen e këtyre formularëve të rezultateve; Që të kemi një konfirmim të saktë se nuk mungon emri i asnjë kandidati dhe nuk mungon asnjë subjekt politik ashtu si janë të certifikuar nga KQZ-ja...

Arianit Elshani: E do dikush fjalën ? Nëse jo, kush është për ?

Ne rregull, atëherë konstatoj që janë miratuar format zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021.

6.Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:

Fazli Stollaj: Shkurtimisht lidhur me aktivitetet lidhur me Këshillin për Mbikëqyrje të Informimit Publik ,me datën 22 shtator Këshilli për Mbikëqyrje të Informimit Publik ka shqyrtuar dhe miratuar videospotin që ka të bëjë me vëzhguesit ,detyrat ,përgjegjësitë por edhe kufizimet e këtyre vëzhguesve gjithashtu në këtë mbledhje është miratuar edhe teksti i cili do të përdoret në spotin që ka të bëjë me mënyrën e votimit për votuesit të cilët janë të infektuar me covid 19 kështu që videospoti pritet të realizohet më vonë në këtë rast është miratuar vetëm teksti gjithashtu në të njëjtën mbledhje është shqyrtuar dhe miratuar dizajni i dy posterave, posteri që ka të bëjë me votuesit me asistencë d.m.th. sqarohet mënyra se si do të votohet me asistencë dhe postieri tjetër mënyra e demantimit të keqpërdorimit të votës në të cilën janë të shënuara udhëzimet se si të veprohet në këtë rast d.m.th. të dy këta postera në ditën e zgjedhjeve do të jenë të vendosur në secilin vendvotim , kjo ishte shkurtimisht lidhur me aktivitetet e Këshillit për Mbikëqyrje të Informimit Publik

Arianit Elshani : A ka dikush ndonjë koment ? Urdhëro z. Rama ?

Alim Rama: Ne Këshilli për Informim Publik, zakonisht jemi marrë me aktivitete me ato fushata që kanë qenë të planifikuara por kanë qenë disa veprime d.m.th., disa angazhime të KQZ-së që nuk po e shoh që janë prezantuar në media sikur ka ardh njoftimi prej mbikëqyrësit kushtimisht e kemi ne menaxher të kontratës për shtypje të fletëvotimeve që është kërkuar që të publikohet , unë nuk e pashë të publikuar por po ashtu ne gjatë vikendit kemi pas trajnimin që të gjitha këto informata janë në dobi edhe interes të qytetarëve të Kosovës kështu që unë besoj se të gjitha aktivitetet e KQZ-së ,Sekretariatit të jenë publike edhe të lajmërohen jo vetëm ato fushata të planifikuara por të gjitha përgatitjet që zhvillohen ato duhet qytetarët të informohen

Sami Kurteshi : Unë po e ngris përsëri çështjen e asaj votojnë personat e vdekur, unë nuk jam mjeshtër i piarit po, mirë kishte me qenë me ia sqaruar opinionit çka do të thotë kjo çështja e personave të vdekur , pranisë të tyre në listë, mospranime të tyre në listë,pastrimi i listave nga personat e vdekur por edhe nga gjithë personat që nuk kanë të drejtë vote , mirë është votimi ka me ndodhë më 17 tetor , unë skam me mundur as ne s'kemi me mund me ndryshuar asgjë mirëpo po të informohet opinionin drejtë cila është procedura çka ka ndërmarrë KQZ-ja, cili është bashkëveprimi me institucionet përgjegjëse të RKS për pastrimin e listave aq sa lejojnë procedurat ligjore.

Aq sa lejojnë mundësitë kohore, tha z. Kurteshi, çështjet e natyrës nuk mund të absolutizohet; Thotë dikush që ka pas në lista njerëz të vdekur, e ai e përjashton natyrën si të tillë dhe thotë krejt është makinë, krejt është administratë, njerëzit vdesin edhe të shtunën edhe të dielën edhe pasi të publikohen listat edhe dikush mundet me qenë edhe ka me qenë në listë vetëm të ju shpjegohet njerëzve që ai është numër minor , shumë i vogël ka mundësi që në krejt Kosovën nuk shkon mbi një numër një shifror që të mos lejohet nga askush qëllimshëm ose pa qëllimshëm që kjo çështje të keqpërdoret , unë nuk e di si bëhet kjo por mirë kishte me qenë me u bë

Florian Dushi : Po megjithatë është mirë që ne me të gjitha kapacitetet tona të angazhohemi në këtë periudhë dhe ta informojmë opinionin drejtë por edhe të koordinohemi dhe të bashkëpunojmë edhe me mediat në kuptimin se në fund të fundit ata janë transmetuesit e të gjitha informacioneve të cilat sikur që opinionin ka nevojë ti ketë edhe ne kemi nevojë ti plasojmë deri te opinionin , çështja e personave të vdekur të ju them të vërtetën kam pasë fatin me vëzhgu shumë procese zgjedhore në botë dhe nga kjo kush më pak e kush më shumë

nuk janë imun pothuajse as një listë e votuesve në këto shtete ka gjithmonë në secilin shtet , në Kosovë ka qenë na ka ndodhë një e keqe që sepse në fund të fundit nuk është gabim sepse mund të kemi emër të personave të vdekur në listë , e keqja në Kosovë ka qenë sepse është keqpërdorë ata që kanë manipuluar me zgjedhjet kanë votuar duke keqpërdorë prezencën e emrave të tyre në listë por e vërtëta manipuluesit e zgjedhjeve kanë votuar ose keqpërdorë këtë edhe për të gjallë edhe për të vdekur ata do të thotë nuk kanë zgjedhë mjete sa herë që kanë pas mundësi me i manipuluar zgjedhjet, me e manipuluar procesin. Prandaj, ka pas një angazhim permanent që pas zgjedhjeve të vitit 2010 që lista e votuesve të ofrohet dhe të jetë sa më e pastër pavarësisht faktit se ajo derivon nga regjistri civil i RKS ne kemi provu në forma të ndryshme që ta mbajmë sa më të pastër sidomos sa i përket prezencës së emrave të personave që kanë ndërruar jetë por prapë po e them është një fat i mirë që në disa zgjedhje të fundit për aq sa unë kam informata nuk di që ka ndonjë rast të konfirmuar që janë keqpërdorë emrat e këtyre personave në listën e votuesve për të votuar do të thoja në emër të tyre prandaj po them është me rëndësi të thuhet që ka mjaft shtete që mund të kenë edhe kanë emra të personave të vdekur në listat e tyre të votuesve por kjo nuk keqpërdoret sikurse tash nuk po keqpërdoret në Kosovë

Ibrahim Selmanaj: Me sa duket, dhe e kemi lexuar një deklaram të një përfaqësuesi të shoqërisë civile. Unë e shfrytëzoj rastin me e falenderuar për përkushtimin që e ka pas administrata e KQZ, dhe z.Kurteshi që ka qenë edhe më i zëshëm, bashkëpunimin që e ka pas me regjistrin civil të Kosovës. Nuk është shqetësuese sipas meje kjo cka shkruhet e thuhet nëpër këto mediumet, sa është me rëndësi përkushtimi që ka pas vetë administrata, KQZ-ja dhe ARC-ja në këtë drejtim. Konsideroj që duhet me vazhduar me seriozitet dhe përkushtim qysh edhe e kemi pas...

Arianit Elshani : Për shkak të korrektësisë më duhet të ritheksoj edhe njëherë , e kemi theksuar dhjetëra herë në mbledhjet e vitit të kaluar por edhe gjatë këtij viti që KQZ ka marrë masa me ato kapacitete dhe mundësi që i ka pas në raport me Ministrinë e Mirëqenies Sociale duke shkuar listën e të gjithë atyre personave që janë heqë nga si përfitues të pensioneve e pastaj edhe të atyre që janë deklaruar në komunat e tyre që pra që kanë deklaruar familjarët në komunat e tyre për vdekjen e atyre familjarëve pra të gjitha këto masa i ka marrë KQZ gjatë vitit të kaluar dhe këtij viti për të pastruar listën , a mund të ketë ndonjë votues i cili realisht është i vdekur mund të figurojë por ky nuk është faj që mund ti atribuohet KQZ-së por

institucioneve tjera në këtë rast pra komunave, ARC te cilët nuk kanë përditësuar me të dhënat reale dhe ky mund të jetë problemi , në raport me KQZ-në ,KQZ ka marrë të gjitha masat me ato mundësi që ka pas, këtu ka qenë gatishmëri e secilit anëtar që vërtetë njëherë e mirë të bëjë një hap më të madh në raport me pastrimin e listave por që tha edhe zt.Dushi pra nuk është problem figurimi i atij emri sa është problem keqpërdorimi emri i atij personi në listën votuese dhe kjo sic, tha nuk ndodhë vetëm për ata që kanë vdekur por mund të ndodhë edhe për ata që janë gjallë sidoqoftë ne si KQZ gjithë kohës kemi kërkuar që sa më shpejtë të zbardhet secili rast i keqpërdorimit të votës nga gjykata dhe me një anë të na lirojë neve kutitë por edhe në anën tjetër të na lirojë nga mundësia që ndonjë komisionar që realisht ka manipuluar në proceset e mëparshme të mos përfshihet më si komisionar dhe që të mos ketë të drejtën e tij që të jetë afër kutive të votimit dhe të prekë vullnetin e qytetarëve të Kosovës

Alim Rama: Unë, mendoj është shumë me rëndësi të ceket masat që i kemi marrë si KQZ në këtë përbërje edhe në përbërjen e kaluar ku vetëm sa herë i kemi larguar nga lista në bazë të rekomandimit mbi 18 mijë persona që kanë qenë nga lista e Ministrisë së Mirëqenies Sociale po ashtu, lista që pranohet nga ARC te gjithë personat e vdekur një ditë para zgjedhjeve kontrollohet edhe në secilin vendvotim shtypet kodi penal d.m.th., dihet përgjegjësitë e të gjithë atyre personave që potencialisht dikush ka mundur të votojë në emër të një personi të vdekur ata procedohen në hetuesi kështu që mendoj të gjitha masat janë ndërmarrë nga KQZ-ja për me siguruar integritetin e këtij procesi zgjedhor...

Fazli Stollaj: Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik, kryesisht është marrë me implementimin e strategjisë për informimin publik mirëpo, unë pajtohem d.m.th., mendimi im është pajtohem që përpos implementimit të strategjisë, është e nevojshme që të publikohen edhe të gjitha aktivitetet që i ndërmerre KQZ-ja dhe Sekretariati në organizimin e procesit zgjedhor...

Të ndryshme!

